

UNIVERSITETI I ARTEVE

BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 8 , datë 15/ 04/ 2019

MBI

**“MIRATIMIN PËR RI-SHPËRNDARJEN E GRANTIT TË AKORDUAR NGA
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË, SHPËRNDARJEN E TË
ARDHURAVE DHE TË REGJISTRIT TË PROKURIMEVE, NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE, PËR VITIN KALENDARIK 2019”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar); Vendimin e Senatit Akademik nr. 10, datë 09.04.2019 “Mbi propozimin për miratimin e ri-shpërndarjes së Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe propozimin për miratimin e regjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2019” dhe pasi shqyrtoi Relacionin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve Znj. Alma Sinanaj “Propozim për shpërndarjen e Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe regjistrin e prokurimeve”, pasi e diskutoi me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ri-shpërndarjes së Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe të regjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2019.
2. Ri-shpërndarjen e Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe të regjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2019, sipas materialit, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe të transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik BISHA (Kryetar)

Risena XHAJA (Anëtar)

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Aida MARTIRO (Anëtar)

Prof. Artan PEQINI (Anëtar)

Prof. Bujar KAPEXHIU (Anëtar)

Lorenc VANGJELI (Anëtar)
